



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1124_04_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 08.05.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 gusht 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H. M. me shifër DPR 8202 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1124_04_14 i datës 23.04.2014.

Arsyetim

Pas kërkesës së konsumatorit lidhur me shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me datë 19.01.2001 i ka lëshuar një shkresë konsumatorit H. M. lidhur me kërkesën e tij, në të cilën theksohet se në KEK nuk ekziston asnjë procedurë apo vendim për lirim të konsumatorëve nga pagesa për energjinë e shpenzuar.

Me datë 17.04.2013 konsumatori prapë ka bërë kërkesë në Departamentin për Konsumator në KEK, me të cilën ka kërkuar nga ta që i tërë borxhi i energjisë elektrike i paguar dhe i vjetërsuar të më shlyhet tërësisht.

Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 22.06.2013 i është përgjigjur ankesës së konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në ankesën për shlyerje të borxhit dhe pasqyrën e shpenzimit (leximit), arsyet për refuzim theksohen se bazuar në dëshmitë rezulton se konsumatori ka bërë riprogramim të borxhit me datë 26.11.2002 dhe 29.03.2007, sipas UA të PSSP të datës 31.12.2002 janë realizuar 590.64€ dhe se konsumatori nuk prezanton asnjë dokument që dëshmon që nuk e ka krijuar këtë borxh.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 01.07.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kërkuar shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 23.04.2014 ka nxjerr vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.



Baza e kundërshtimit të konsumatorit të theksuara në ankesë është se borxhi i KEK-ut prej 1,935€ i është bartur në llogarinë e KEDS-it pa të drejtë. Në ankesë konsumatori ka theksuar se nga viti 2007 e deri 2014 janë me mbingarkim, pra janë të fryera. Konsumatori në ankesë ka theksuar se ka bërë pagesa nga 1999 – 2002 dhe se ka qenë i kushtëzuar me i pagu për shkak të shkyçjes dhe se edhe Qendra për punë Sociale i ka liruar të gjithë konsumatorët nga pagesa prej vitit 1999 – 2001 dhe se atëherë ka qenë vetëm shuma prej 13€, por që me datë 31.12.2002 borxhi është përfshirë prapë prej 604 DM. Me datë 29.03.2007 konsumatori thekson se çuditërisht i erdhi borxhi prej 1486.57€ dhe se u detyra ta riprogramoj për të shpëtuar nga shkyçja. Mesatarja e përdorur në vendimin e DMK nuk përkon me realitetin pasi që njehsori gjerë më 2013 nuk ka punuar tarifa e lirë por vetëm tarifa e lartë. ZRRE duhet të merr për bazë edhe pagesat e konsumatorit për çdo muaj dhe se borxhi i KEK-ut prej 1935€ është bartur në faturat mujore dhe konsumatori potencon se është pagues i rregullt i faturave të KEDS-it. Konsumatori kërkon nga Bordi i ZRRE të definon borxhin ndaj KEK dhe KEDS-it ashtu që për borxhin ndaj KEK-ut të vazhdon procedurën gjyqësore. Konsumatori në ankesë ka theksuar se është pensioner dhe se nuk ka shansa minimale me i pagu borxhin e KEK-ut.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se sipas transaksioneve të konsumatorit DPR – 8202 nga periudha 10/1999 – 07/2002 konsumatori ka pasur shpenzim të energjisë elektrike dhe se borxhi i krijuar deri në atë periudhë ka qenë 590.64€. Fatura e parë e energjisë elektrike e evidentuar në transaksionet e konsumatorit ka qenë fatura e muajit 08/2002 në vlerë prej 13.90€ dhe se KEK e ka ngarkuar edhe me borxhin në vlerë prej 590.64€, si borxh paraprak të papaguar. Sipas analizave të transaksioneve të konsumatorit vërehet se me datë 26.11.2002 konsumatori ka nënshkruar kontratë për riprogramimin e borxhit të energjisë elektrike, duke pranuar borxhin që ta paguaj me këste si dhe faturat mujore nga ajo periudhë e tutje. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se me datë 31.12.2002 duke u bazuar në Urdhëresën Administrative 2002/19 dhe 2002/20, KEK-u i ka shlyer konsumatorit borxhin e energjisë elektrike prej 590.64€. Me datë 29.03.2007 prapë konsumatori ka nënshkruar një kontratë me KEK-un për riprogramimin e borxhit të energjisë elektrike për vlerën e shpenzuar prej 1,486.57€, ashtu që borxhin e riprogramuar ta paguaj me këste për muaj në vlerë prej 46.10€ plus edhe faturën mujore me shpenzime nga ajo periudhë e tutje, por që sipas pasqyrës së gjendjes konsumatori nuk i është përmbajtur kontratës së nënshkruar nga veti dhe me datë 26.01.2008 i është ndërprerë kontratës e riprogramimit.

Sa i përket pjesës së ankesës së konsumatorit rreth mbingarkimit nga periudha 2007 e deri më 2014 dhe në pohimin se gjerë më 2013 nuk ka punuar tarifa e ulët por vetëm ajo e larta, si dhe mesatarja e llogaritur nga DMK nuk përkon me realitetin, Bordi konstaton se mesatarja e përdorur nga DMK në vendimin e tyre paraqet mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike të llogaritura në të dy tarifat (tarifa e lartë dhe tarifa e ulët), dhe se sipas rrjedhës së energjisë elektrike aktive mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike nga periudha 08/2002 deri më 12/2006 është 620 kWh/muaj, ndërsa nga periudha 01/2007 deri më 03/2014 është 699 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE thekson se sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1124_04_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar